



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin

PROCESVERBAL

Tiranë, më 04.02.2019, ora 12:00

Drejton mbledhjen:

Niko Peleshi – kryetar i komisionit

Rendi i ditës:

Seancë dëgjimore me grupet e interesit, lidhur me shqyrtimin e projektligjit “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 64, datë 31. 5. 2012 "Për peshkimin", të ndryshuar".
(komision përgjegjës)

Marrin pjesë:

Niko Peleshi, Besnik Baraj, Ilir Beqaj, Rrahman Rraja, Robert Bitri, Eglantina Gjermani, Tatjana Nurçe, Andrea Marto, Rakip Suli, Ilir Ndraxhi, Edmond Leka dhe Edmond Panariti.

Mungojnë:

Florjon Mima, Lorenc Luka, Lefter Koka Endri Hasa, Izmira Ulqinaku, Hekuran Hoxhalli dhe Agron Çela.

Të ftuar:

Roland Kristo – Zëvendësministër i Bujqësisë
Gjergj Luca – përfaqësues nga Konfederata e Prodhuesve të Peshkimit dhe Akuakulturës

Helidon Rugia – përfaqësues nga Shoqata e Investitorëve të peshkimit Durrës

Besim Troplini – përfaqësues nga OMP-ja-ja Durrës

Mezan Mezani – përfaqësues nga OMP-ja Vlorë

Arian Cinari – përfaqësues nga OMP-ja Shkodër

Filip Paco – përfaqësues nga OMP-ja Nartë

Niko Peleshi – Vazhdojmë me pjesën e dytë të rendit të ditës. Seancë dëgjimore me grupet e interesit, lidhur me shqyrtimin e projektligjit “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 64, datë 31. 5. 2012 "Për peshkimin", të ndryshuar".

Arjan Cinari - ... këtu për të siguruar të ardhmen tonë, por njëkohësisht mbrojmë edhe resurset peshkore në liqenin e Shkodrës, liqenin e Ohrit, liqenin e Prespës dhe gjithkund ku ne shtrihemi si organizatë.

Sa më shumë të flasësh, njeriu... Ne e kemi punën të përditshme. Nga ana ligjore jemi të mirinformuar, sepse kemi pasur vazhdimisht kontakte për mbarëvajtjen.

Ky ligj duhet të bëhej më parë, sepse u pa që organizatat e peshkimit po jepnin rezultat. Besoj se është me vonesë krijimi i këtyre organizatave.

Për bregdetin apo pjesë të tjera, që janë pa organizata, ka 20 e ca vjet që nuk dihen statistika, se sa është zënë, kush i zë dhe se si zihen.

Besoj se ka ardhur koha që, ashtu siç është te liqeni i Shkodrës, liqeni i Prespës apo liqeni i Ohrit, të jetë gjithkund. Peshkimi të marrë vëmendjen që i takon dhe peshkatarët të marrin kontributin që japin.

Faleminderit!

Niko Peleshi – Për projektligjin, specifikisht, jeni të mirinformuar?

Jeni dakord me ndryshimet? Nuk keni ndonjë vërejtje?

Helidon Rugia – Përshëndetje!

Jam Helidon Rugia, kryetar i Shoqatës së Investitorëve të Peshkimit në Durrës, si dhe administrator i kompanisë “Koral”.

Me sa jemi informuar nga ligji për peshkimin, këto ndryshime janë shumë të nevojshme.

Janë ndryshime shumë të vonuara, për faktin se nga shfrytëzimi, po e quaj, barbar, i gjithë bregdetit në këto vite, shikojmë që shumë specie, që deri para shumë vitesh ekzistonin, tani janë në zhdukje.

Me sa e kemi lexuar ligjin, këto ndryshime po bëhen në bazë të të gjitha rregullave që kanë shtetet fqinje, si: Greqia, Italia, Kroacia, që, normalisht, kanë shumë rezultate në aplikimin e ligjit.

Shfrytëzimi që është bërë penalizon edhe industrinë përpunuese.

Një ndër problemet e tjera që shikojmë te ligji për peshkimin është edhe ferma biologjike, e cila duhet të aplikohet, sepse kur peshku riprodhohet, gjuetia duhet të ndalohet.

Ne e kemi ngritur këtë problem shumë herë edhe në ministri, por ata thonë se ne nuk kemi fonde për ta aplikuar këtë.

Ne jemi dakord me të gjitha ndryshimet që po bëhen, sepse janë për të mirën dhe mbarëvajtjen e sektorit.

Kaq kisha.

Niko Peleshi – Faleminderit!

Relatore, keni ndonjë gjë?

Eglantina Gjermeni – Faleminderit, kryetar!

Faleminderit, zotërinj, për ardhjen tuaj këtu, për angazhimin, si dhe vlerësimet tuaja!

Jo vetëm që organizimi i seancave dëgjimore është detyrim ligjor, por në këtë komision është një traditë shumë e mirë, e krijuar ndër vite, që për çdo projektligj që diskutohet, organizohet seancë dëgjimore me grupet e interesit, për të shkëmbyer përvoja dhe, në rast se ka, edhe sugjerime apo gjëra që nuk janë arritur gjatë bashkëpunimit me ministritë përkatëse, në mënyrë që ne si komision të mund të ndihmojmë ose të marrim mendime të tjera, që mund të mos jenë dhënë.

Është ndër rastet e rralla që vini këtu dhe jeni plotësisht dakord me projektligjin. Për këtë më vjen shumë mirë!

Doja t'ju pyesja në mënyrë specifike: si do të ndikojë në punën tuaj ky projektligj, në momentin kur do të hartohet?

Si do të bëhet puna me peshkatarët që janë individualë, që dalin për qejf dhe e kanë pasion apo sport peshkimin? Është gjë shumë e mirë që të organizohen në shoqata.

Unë e kuptoj shumë mirë, IPARD-i mund të ketë mundësi më të mëdha për të financuar. Në përgjithësi, në bujqësi, në qoftë se kemi grupime të mbledhura, impakt është më i madh.

Nga ana tjetër, nuk duhet të përjashtojmë këta individë, të cilët e kanë këtë pasion.

Si do të bëhet puna me ta? Duhet patjetër të jenë anëtarë shoqate? Si e mendoni ju këtë?

Helidon Rugia – Mendoj se ky nuk është ndonjë problem, sepse në ligj parashikohet vendosja e rregullave. Aktualisht, është pa rregulla, pavarësisht se funksionojnë inspektoratet, por ne jemi përpara një fakti, që kujt i mbushet mendja, mund ta ushtrojë, jo vetëm te pjesa ...

Realisht tani funksionon pak më mirë, por besoj se të gjithë e keni dëgjuar që bregdeti është shfrytëzuar në mënyrë barbare. Nuk po diskutoj vetëm pjesën e peshkatarëve pasionantë, sepse kemi edhe pjesën e keqbërësve, të cilët kryejnë gjueti me dinamit, mina kundratankë, që e kanë...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Po.

Tani është i reduktuar, por normalisht i ka dhënë efektet e veta, siç e thashë edhe më parë, që bregdeti quhet ndryshe në gjuhën tonë si “materniteti i peshkut”. Nëse nuk do të shfrytëzohet siç duhet, normalisht edhe riprodhimi do të jetë shumë i vogël, për të mos thënë drejt zhdukjes, sepse janë momentet, është koha dhe mënyra se si duhet të jetë gjuetia.

Niko Peleshi – Eli, më fal që ju ndërpres!

Pyetja ishte shumë konkrete. Në fakt, mbase Rolandi mund ta thotë më mirë, por peshkatarët sportivë duhet të jenë pjesë e shoqatës, apo jo?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Niko Peleshi – Roland, të lutem!

Person – Unë kam parë edhe disa komente që janë bërë në gazeta. Kjo nuk merret me peshkimin çlodhës, argëtues, sepse ky aktivitet nuk ka qëllime tregtimi, është tashmë i rregulluar në ligj. Një pjesë të vogël, për formën e peshkimit turistik, që kishim për procedurat, do të përcaktohet me udhëzimin e ministrit. Peshkimi çlodhës, argëtues ndahet në tri kategori: peshkimi amator, peshkimi sportiv dhe peshkimi turistik.

Peshkimi amator është kompetencë e pushtetit vendor, është e përcaktuar qartë në ligj.

Peshkimi sportiv, kap dhe lësho, pa qëllim për ta marrë peshkun mbrapa, u jepet shoqatave.

Sot ekzistojnë shoqata, për të cilët ne kemi dhënë 3-4 autorizime. Janë mbrojtësit e detit, që bëjnë aktivitete kombëtare në këtë drejtim dhe nuk kanë asnjë pengesë.

Për sa i përket peshkimit turistik kemi bërë një ndryshim të vogël, kemi shtuar fjalën “procedurat”. Ndryshimet që ne parashikojmë nuk kanë të bëjnë me peshkimin çlodhës argëtues, nuk i përfshijnë dhe do të vazhdojnë sërish aktivitetin.

Niko Peleshi – Po peshkim turistik çfarë do të thotë?

Roland Kristo – Peshkim turistik është kur shqiptarë ose të huajë mund të vijnë me jahte për një periudhë 10-ditore dhe gjatë kësaj periudhe do të duan të hedhin edhe 2-3 grepa në det, si një lloj aktiviteti.

Niko Peleshi – Kjo është e lirë, apo e disiplinuar?

Roland Kristo – Ligji përcakton që duhet disiplinuar. Mungon përcaktimi i procedurave, që sot nuk është bërë zbatimi i saj. Domethënë, sot vjen një jaht dhe kërkon të zhvillojë peshkim turistik. Mua vjen keq që po e them, por pavarësisht se ligji i peshkimit ka hyrë në fuqi në vitin 2012, sot të drejtën e jep kapitaneria e portit, Policia Kufitare, kushdo,

por vetëm peshkimi nuk e jep, sepse mungon mënyra se si do të rregullohej ose mënyra si do të merrnim leje për të zhvilluar një aktivitet të tillë.

Nëse një turist i huaj ose dikush do të dojë të qëndrojë 10 ditë në aktivitetin shqiptar, koha për të përgatitur lejen mund të dojë 2 javë. Atëherë, sa të vijë dhe të largohet, leja nuk ka dalë ende. Duke shtuar fjalët “procedurat përcaktohen me udhëzim ministri”... E thashë herën e kaluar, ne do të përdorim modelin kroat, një faqe të dedikuar, ku gjithsecili që vjen dhe është i interesuar të zhvillojë një aktivitet të tillë, mjafton të vendosë të dhënat e barkës, të dhënat e veta dhe të bëjë natyrisht edhe pagesën për sa ditë e kërkon, automatikisht sistemi e pajis me leje. Pra, në momentin kur mbërrin në portin përkatës, e ka marrë edhe lejen për të qëndruar 5, 10 ose 15 ditë. Ky aktivitet do të jetë në kontroll, ndërsa për menaxhimin, ka të bëjë me vendimin nr. 407 të Këshillit të Ministrave, sepse ka specie të lejuara, specie të ndaluara. Ai do të jetë i detyruar ta zbatojë të gjithë pjesën tjetër të legjislacionit. Pra, janë të njëjtat rregulla që kanë të bëjnë me peshkimin industrial dhe tregtar. Ky është formati që përdoret sot në të gjithë botën, nuk e kemi shpikur ne.

Arian Cinari - Në lidhje me peshkatarët e tjerë, që mund të dalin jashtë nga kjo formë organizimi, ne kemi një vendim të Këshillit të Ministrave në nëntor të vitit 2016, i cili e ka përcaktuar numrin e mjeteve lundruese për çdo kategori peshkimi. Për peshkimin e vogël artizanal është përcaktuar numri 300. E thashë edhe herën e kaluar, sot janë të pajisur me leje vetëm 100, janë 200 vende, që zyrtarisht i quaj vende bosh, pavarësisht se janë 100 e ca të tjerë që zhvillojnë aktivitet dhe nuk janë të pajisur me leje. Pra, nuk është asnjë lloj forme përjashtimi ose mbyllje numri dhe largimi i atyre që zhvillojnë aktivitetin, nëse do të dalin ose do të rrinë. Numri është 300. Në momentin kur ne, pas projektit të operacionit italian, do të kemi ekzakt numrin e varkave që peshkojnë në bregdet, sepse do të fillojmë një census tani, do ta rishikojmë vendimin e Këshillit të Ministrave për të parashikuar numrin ekzakt të subjekteve që do të zhvillojnë aktivitet në bregdet. Por koha, ku cilido që është pranë bregut të detit, të dalë me një varkë për të peshkuar pa rregulla, pa asnjë lloj forme kontrolli, duhet të marrë fund një herë e mirë. Mua më vjen keq ta them, por sot bregdeti është ndarë me rrjete të formatit “tokë e xanun”. Domethënë, kushdo hedh rrjetat dhe nuk i ngre asnjëherë gjatë gjithë ditës. Rrjetat rrinë 24 orë, në një kohë kur rrjetat duhet të hidhen në darkë dhe duhen ngritur në mëngjes, prandaj bregdeti është varfëruar.

Zotërinjtë këtu, sidomos investitorët e mëdhenj, kërkuar ndalimin biologjik. Ne e kemi në ligj, por natyrisht kërkon mbështetje financiare. Gjatë kohës që anijet nuk do të peshkojnë për 1 ose 2 muaj, duhet t’u japësh subvencion. Pjesa më e madhe e peshqve dhe peshqit që zotërinjtë kapin në ujërat mbi 3 milje, shtohen në bregdet. Peshkimi pa asnjë lloj

kriteri në bregdet, natyrisht që ndikon tek investimet. Zotëria mund të ketë bërë 10-15 milionë euro, të tjetrit kanë bërë po aty. Pra, rreth 100 milionë euro që është flota jonë, investimi në det ose në tokë, në përpunim, në burim është një situatë që duhet rregulluar urgjentisht.

Faleminderit!

Niko Peleshi – Dakord.

Zoti Baraj ka pyetje. Më pas zonja Gjermani.

Besnik Baraj – Unë do të doja të dija si fillim nëse është dikush këtu që përfaqëson peshkatarët artizanalë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Domethënë, për mua takimi sot është i padobishëm, sepse ne kishim parasysh të fokusoheshim, të merrnim opinionin e tyre. Nuk ka nevojë të flasë këtu në emër të tyre dikush që është për peshkimin industrial.

Niko Peleshi – Më falni, por Ariani është kryetari i ...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Besnik Baraj - Po, ata pa varka ose me një varkë.

Niko Peleshi – Ariani është edhe drejtori i Organizatës së Menaxhimit të Peshkimit të liqenit të Shkodrës, ku teorikisht përfshihen të gjithë.

Besnik Baraj - E dyta, ju folët për peshkimin turistik. Unë mund të shkoj turist 10 ditë, në Shkodër ose në Vlorë. Nuk kam jaht. Duhet të identifikohem patjetër se do të hedh grepat?

Arian Cinari – Po, patjetër që edhe ju duhet të identifikoheni.

Do të kenë parasysh një gjë. Ne sot ...

Besnik Baraj – Mos është e ekzagjeruar kjo? Domethënë, të kalojmë nga “Fiat”-i, i vitit 1950, në “Ferrari”, për një ...

Arian Cinari – Jo.

Besnik Baraj – Më duket e ekzagjeruar, sepse nuk e kontrolloni dot, edhe nëse doni ju.

Arian Cinari - Unë e di që nuk e kontrollojmë dot, por ligji e parashikon që peshkimi amator menaxhohet nga pushteti vendor. Merrni parasysh se qejfi paguhet. Ju shkoni për qejf dhe qejfi paguhet. Për biznesin ne kemi sistemin e tarifave më të ulët që ekziston. Ka që nga viti 2002 që nuk është ndryshuar niveli i taksave dhe lejeve për sa i përket biznesit.

Për sa i përket peshkimit amator, në momentin kur do të fillojë të identifikohet, në fund të fundit jeni një përdorues i resursit, merrni një sasi peshku nga ky resurs, sado minimale, që duhet evidentuar, duhet llogaritur në funksion të gjendjes së resursit dhe natyrisht, në funksion të qejfit, duhet paguar.

Besnik Baraj – Sinqerisht më duket i ekzagjeruar dhe nuk e di nëse do ta kontrollojmë dot, sepse ne shpesh miratojmë ligje që janë jashtë kapacitetit tonë. Ne duhet të kontrollojmë kryesisht peshkimin që dëmton realisht... Pra, problematikën që tha zotëria, që është materniteti. Kur kalojmë në bregdet janë shumë pak njerëz që gjuajnë. Herën e parë bëra një pyetje: ç'vlerë zë në prodhimin vendas peshkimi artizanal, në raport me peshkimin tjetër, por nuk mora përgjigje.

Dritan Bici – Të bëj një pyetje.

Shkon dot në Itali për qejf dhe të gjuash në një liqen ose lum? Merre grepin dhe shko.

Besnik Baraj – Deri para 15 vjetësh gjuhej. Tani nuk e di.

Dritan Bici – Po ta them unë që nuk gjuan dot.

E para, duhet të kesh leje që të shkosh të gjuash dhe, e dyta, e ke të përcaktuar edhe sasinë e peshkut që ti kap. Ti mund të kapësh edhe 100 peshq në ditë, por je i detyruar të marrësh dy. Nëse të gjendet peshku i tretë, ti gjobitesh keq. E kupton?

Nëse ne nuk kemi arritur atje ku duhet, ligjet duhet t'i bëjmë siç duhet. Kur të arrijmë, të arrijmë.

Roland Kristo – Pjesa e peshkimit amator është tashmë e rregulluar në ligj, nuk po e prekim, siç e tha zotëria. Nuk merret ministria me rregullimin e peshkimit amator. Ministria mund të përcaktojë numrin maksimalis të peshkatarëve amatorë në një zonë të caktuar, kurse lëshimi i lejes ose pagesës së tarifës përkatëse është pjesë e pushtetit vendor, nuk është problematikë e ministrisë.

Dritan Bici – Logjika është të vijmë te pjesa që, atë që u krijojmë turistëve kur vijnë këtu, t'ua krijojmë edhe shqiptarëve kur shkojnë atje. Normalisht, më pas, se sa e ndjekin atë, kapin 3 ose 4, nuk kemi arritur ende atje. Nëse do pushteti lokal, le ta kapë, por të krijojmë kushte që çdo amator të shkojë me të njëjtat kushte.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Nuk e pengojnë edhe sot. Unë kam disa shokë që me të vërtetë janë shumë qejflinj, e kanë pasur traditë nga gjyshi, i ati dhe ky vet. Ata e kalojnë të shtunën dhe të dielën andej. Në disa momente më thoshin se donin të shkonin në Karavasta, që unë t'u thosha atyre të shoqatës për t'i lejuar. Nëse ka mundësi, të paktën të mos të jepen të gjitha zonat, të lihen

edhe disa zona të lira ku pushteti lokal të japë lejen për ta. U dha Karavastaja në Divjakë, nuk lejonin njeri të futej.

Robert Bitri – Në fakt, edhe unë po i bashkohem kësaj pyetjeje. Tek ujërat e brendshme (rezervuarë, ligatina), që janë dhënë për peshkim me kontratë, si është hapësira? Sa është e mundur të ushtrohet peshkimi sportiv apo peshkimi çlodhës aty? Sepse ky problem qëndron gjithandej. Ai që e ka marrë rezervuarin, që është dhënë për peshkim me kontratë, nuk i lejon peshkatarët të shkojnë për argëtim dhe të peshkojnë aty.

Roland Kristo – Më fal!

Kemi gjueti edhe në tokë. Kush është gjuetar kërkon një leje, pajiset me çifte dhe ushtron pjesën e kënaqësisë që ka dhe askush nuk e ndalon dot. Pse për detin të mos bëhet e njëjta gjë? Kush e ka pasion, ta kërkojë lejen, ta marrë... Askush nuk e ndalon.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk mund të dalë një njeri të gjuajë me çifte pa leje, sepse e kap policia dhe e fusin në burg...

(Diskutime pa mikrofon)

Thjesht mund të bësh një kërkesë, të pajisesh me armë dhe...

Niko Peleshi – Dakord, por këtu ndryshon puna. Nuk po flasim për detin, por ujërat e brendshme janë dhënë pothuajse të gjitha me... Unë dhe Rolandi nuk dhamë ndonjë... I kanë dhënë ata para nesh. Të gjitha ujërat janë dhënë për peshkim. Tani nuk kanë se ku të shkojnë peshkatarët, qoftë edhe ata që kanë leje. Me leje ose pa leje, peshkatarët amatorë nuk kanë se ku të peshkojnë në ujërat e brendshme.

Peshku yt nuk është në vaskën tënde, por është në rezervuarin e të gjithëve. Prandaj e thashë në parantezë, Dritan, që unë dhe Rolandi nuk kemi dhënë ndonjë...

(Diskutime pa mikrofon)

Ju lutem, ta vazhdojmë diskutimin me radhë dhe me leje!

Berti, të lutem!

Desha të sqaroj pyetjen time, para se ta marrë fjalën zoti Panariti.

Natyrisht, në qoftë se e lë në dëshirën e palëve, secili mbron interesin e vet. Siç e tha edhe zoti Bici, mund të ketë një rregullim, që edhe atje ku ti ke hedhur rasatin unë kam të drejtë të peshkoj, por deri në, po themi, dy kilogramë peshq, pra me një sasi të caktuar, që të mos quhem peshkatar tregtar, por që peshkoj për qejf. Në qoftë se kjo është pjesë e kontratës, jam i detyruar të të lejoj, siç jam i detyruar të lejoj edhe përdorimin për bujqësi të ujit të rezervuarit.

Me këtë logjikë, pyetjen që më bëre, Roland, mund t'ia bësh edhe bashkisë, nëse ka apo jo legjitimet ta përdorë ujin për bujqësi. Ai mund të thotë se unë kam hedhur peshkun këtu dhe është rezervuari im. Pra, ka të drejta të ndara. Në këtë rast, e drejta për ta përdorur jo vetëm për peshkim, por edhe për bujqësi, mund të ndahet edhe me peshkimin për qejf.

Deritan Bici -Në vendet e tjera, peshkatarët pasionantë shkojnë në këto rezervuare dhe peshkun që kapin e lëshojnë prapë. Peshkun që kapin nuk e marrin për në shtëpi apo... Atje ka liqene dhe kush do shkon atje, paguan tarifën dhe për kënaqësinë e tij e kap peshkun dhe e hedh përsëri në ujë.

Niko Peleshi - E sqaroi Rolandi, ky quhet peshkimi sportiv.

Zoti Panariti e ka kërkuar fjalën.

Edmond Panariti – Faleminderit, zoti kryetar!

Dëshiroj të falënderoj përfaqësuesit e ministrisë, veçanërisht sipërmarrjet e peshkimit, që janë këtu për të diskutuar për ndryshimet në projektligj!

Mendoj që peshkimi artizanal nuk është shqetësimi real i sektorit, por është dekori... Bëjmë mirë që e diskutojmë, sepse ka nevojë të normohet, të rregullohet dhe të mos jetë, e thashë edhe herën e kaluar, thjesht vullneti i ministrit. Ka nevojë për rregullime, për t'u mbrojtur nga abuzimet, për ta vendosur mbi kritere.

Unë mendoj se problemet e sektorit janë shumë më të mëdha se kjo temë që ne i dedikuar goxha hapësirë në diskutimet tona për atë se çfarë duhet bërë.

Kisha një pyetje: ju, si përfaqësues të sipërmarrjes dhe të shoqatave të peshkimit, a jeni të kënaqur me sistemin aktual të identifikimit, regjistrimit dhe raportimit të anijeve të peshkimit? Për mua, kjo ka qenë një gangrenë e madhe gjatë kohës që kam qenë ministër, një përplasje midis atij që lëshonte sinjalin dhe përfituesve të shërbimit, nga pikëpamja se kush do ta mbante, kush do ta paguante e të tjerë. Doja të dija se si e vlerësoni ju situatën me këto ndryshime. A funksionon ajo? Sepse kjo është e lidhur, natyrisht, me disiplinimin e sektorit, me formalizmin e tij, por edhe me çështje të sigurisë, të pengimit të trafikeve...

Së dyti, meqenëse unë këtu shikoj që është edhe zoti Helidon, për të cilin kam një respekt dhe një vlerësim të jashtëzakonshëm, mendoj se maja e diamantit e industrisë së peshkimit janë pikërisht investimet e jashtëzakonshme që janë bërë në sektorin e peshkimit. Këtu kemi firmën “Koral”, por do të thosha se edhe zoti Luca është një aktor shumë i fuqishëm në sektorin e peshkimit. Kanë bërë investime të jashtëzakonshme, që nuk i gjen... Në Europën Juglindore janë të parët.

Këtu ka një handicap jashtëzakonisht të madh dhe për këtë do të doja mendimin tuaj. Ne kemi kapacitete jashtëzakonisht të mëdha përpunuese, ndërkohë që kemi kufizime në

sasinë që na lejohej të përpunojmë dhe të peshkojmë. Kjo bën (e kemi diskutuar disa herë, zoti Helidon) që fabrikat të punojnë maksimumi 4 muaj dhe të mos kenë mundësi për t'u furnizuar me lëndë të parë.

Pyetja ime është: a mendoni që ky komision mund të ketë një rol këtu, për t'ju ndihmuar në kërkesën për rritjen e kuotës së përpunimit të açugeve apo të peshqve të importit, por edhe mirëfillti për kuotën e peshkimit, qoftë duke thirrur këtu përfaqësues të Bashkimit Europian në delegacion dhe për të bërë një bisedë të hapur? Se duhet bërë një demarsh. Kjo nuk është vetëm përpjekje lobingu individual, por mund të kemi nevojë edhe për një qëndrim institucional, sepse sipërmarrja private këtu ka hedhur shumë para. Për shembull, zoti Helidon, përveç investimit që ka bërë atje, ka bërë një investim të jashtëzakonshëm edhe në Kavajë. Pra, janë rritur shumë kapacitetet përpunuese. Ato kërkojnë materiale. Kërkojnë materiale që vijnë nga peshkimi vendas, por edhe nga importi, që është industri përpunimi, e cila, në një farë mënyre, i jep frymëmarrje sipërmarrjes, por edhe punëson njerëz, rriten tatimet dhe taksat që i shkojnë buxhetit të shtetit.

Kjo është ndihma reale që ne mund të japim, qoftë me një ndërhyrje në projektligj, qoftë edhe duke thirrur, pse jo, përfaqësues të Bashkimit Europian, duke i bërë një kërkesë zyrtare Komisionerit për Peshkimin. Ministri i Bujqësisë ndoshta mund të shkojë atje, të presë biletën e avionit, se ia vlen në të tilla raste, së bashku me disa sipërmarrës, të takojë Komisionerin e Peshkimit dhe t'i thotë: "Zotëri, e di si është puna? Ne kemi bërë investime të jashtëzakonshme. Nuk mund të lejojmë që me këto investime të punojmë vetëm dy muaj. Prandaj, mundësisht, na i rrisni kuotat."

Kemi bërë një bisedë paraprake dhe ka disa mënyra se si mund të rriten kuotat.

Mënyra e parë është duke kërkuar që të rritet kuota në total.

Mënyra e dytë është me artefakte të karakterit "ul përqindjen e vajit" e tjerë.

Të gjitha këto janë ndihma konkrete që ne i japim sektorit, nëse duam ta zhvillojmë.

Çështja e anijeve, rritja e kapacitetit të peshkimit, teknologjia, ndonjë marrëveshje me flotat e vendeve fqinje apo kreditimi i sektorit, për mendimin tim, do të ishin thelbi i ndihmesës sonë, qoftë me ndonjë ndërhyrje në projektligj, qoftë me nisma të tjera paralele.

Sigurisht, edhe peshkimi artizanal, që, si të thuash, është piktura e sektorit, ka nevojë të rregullohet.

Unë mendoj që sektori, aktualisht, vuan dhe ka nevojë për ndërhyrje dhe ndihmë shumë të madhe, veçanërisht nga ne që jemi ligjvënës dhe përfaqësues të qeverisë, për të shfrytëzuar potenciale, që akoma janë në nivele potencialesh dhe nuk kthehen realisht në të ardhura konkrete.

Këto pyetje kisha. Natyrisht, mund të më ndihmojë edhe zëvendësministri, por do të doja që përfaqësuesit e peshkimit, të sipërmarrjes dhe të shoqatave të më jepnin një përgjigje.

Helidon Rugia – Ato që tha profesor Panariti janë realisht problemet kryesore të sektorit.

Për industrinë e përpunimit ne kemi të paktën një produkt, që, realisht, për efekt të problematikave që ka pasur në disa vende të tjera, si: Maroku, Tunizia, Egjipti, është orientuar, për fat, në Shqipëri. Shumë fabrika janë hapur këto vitet e fundit. Rezultatet për cilësinë e produktit janë shumë të mira dhe produkti ynë konkurron... Shqipëria zë vendin e parë si eksportues në Europë dhe ka kapacitete për sa i përket açuges, por, realisht, jemi të penalizuar, sepse nuk kemi kuota. Kuotat që ne disponojmë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

1600.

Kuotat që ne disponojmë, duke u terezitur pak, arrijnë deri në fund të gushtit. Në shtator, tetor, nëntor dhe dhjetor, ne penalizohemi dhe nuk punojmë dot. Për këtë jemi munduar, si grupe interesi, si shoqata, për të lobuar, por mbështetja juaj mund të jetë shumë më e madhe se ajo që... Janë disa gjëra, që, pa ndihmën tuaj nuk mund të...

Në atë industri, këta 3-4 vjetët e fundit, minimalisht, mund të jenë punësuar rreth 5000 vetë. Një ndër problemet kryesore që hasim, përveç pjesës së kuotave, që na penalizon shumë, është se nuk kemi fuqi punëtore, nëse duam të shtojmë punonjës.

Për identifikimin e mjeteve lundruese është bërë një zhurmë shumë e madhe, sepse peshkimi është parë gjithmonë si ajo delja e zezë, sikur gjithë sektori është kontrabandist, sikur merren të gjithë me naftë, me klandestinë, por, aktualisht, sektori është rreth 90% i formalizuar (ky mund të jetë ndër të paktët sektorë me këtë shifër), me skemën e naftës që është bërë..

Me sa kemi parë, pjesën e *globox*-eve ky ligj nuk e prek.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Roland Kristo – Mund të bëj një sqarim? Edhe herën e kaluar nuk u sqarua kjo.

Së pari, gjatë vitit të kaluar kemi pasur një debat për çështjen e interpretimit të ligjit për pjesën e *globox*-it.

Neni 72 i ligjit përcakton se kostot e transmetimit satelitor të komunikimit të anijes me satelitin përballohen nga anijet e peshkimit. Ne kemi dashur që, aparati, duke qenë një mjet kontrolli nga ministria, të mbulohet me shpenzimet e buxhetit të shtetit. Problematika e kësaj çështjeje është pak e vështirë për mënyrën se si do të bëhet.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Për aparatin kemi një propozim të sjellë nga shoqata dhe kushton rreth 600 euro, kurse në rastin e blerjes së aparatit tek e tek mund të kushtojë 2000-3000 euro. Kjo është pjesë e negocimit që bëhet me firmën që sjell sinjalin. Duhet të kemi parasysh se (për këtë ka qenë gjithë debati) paratë për sinjalin paguhet nga peshkatarët dhe kjo është pjesa më e madhe e kontributit të peshkatarëve në 5 vjet, ndërsa kostoja e aparatit është pjesa më e vogël.

Në qoftë se tenderi do të ishte një gjë e thjeshtë, shteti shqiptar do të blinte aparatin më të lirë, që ndoshta ndonjë kompani mund ta sillte edhe falas, por do t'u vendoste peshkatarëve koston e transmetimit të sinjalit 100 euro në muaj.

Nëse do të shkojmë te një aparat pak më i shtrenjtë, synimi kryesor është (në bazë të propozimit që kanë bërë peshkatarët, ka qenë rreth 35 euro në muaj, 25 euro +10 euro mirëmbajtja) të gjendet forma e rregullimit, që peshkatarët të mos paguajnë koston më të lartë. Kjo ishte pjesa ku kemi pasur debatin.

Gjatë vitit të kaluar, specifikimet teknike të sistemit u ribënë nga e para me mbështetjen e Komisionit të Përgjithshëm të Peshkimit për Mesdheun. Nga vlerësimi ka dalë një problematikë. Nuk janë vetëm aparatet që kanë dalë jashtë funksionit. Ato janë aparate të gjeneratës së vjetër tashmë, që nuk janë mirëmbajtur, por është i gjithë sistemi që duhet të ringrihet. Sapo të miratohet ligji... Ne kemi përcaktuar në ligj (i vetmi ndryshim që është bërë) ndarjen ekzakte se çfarë është MTU-ja, pra se çfarë është aparati, që të mos kemi më debat se cila është pjesa që mbulon buxheti i shtetit dhe cila është pjesa që mbulojnë anijet e peshkimit. Fondet tashmë janë pranë AKSH-it. Sa të kalojë ligji, do të përfundojnë procedurat e tenderimit për ta rivënë në punë sistemin, jo vetëm për blerjen e aparateve (kjo është pjesa që do të instalohet në bordin e anijeve të peshkimit), por për ngritjen e të gjithë sistemit, për serverët, që do të bëhen nga e para, për të cilët jemi në fazë diskutimi: ose do të ngrihen me QNOD-në, ose do të ngrihen pranë AKSH-it. Nëse do të shkojnë në QNOD-, do të jemi përsëri para fakteve: energji elektrike, kolpo dhe gjithë atyre që ka pësuar sistemi në këto vite, si rezultat i problematikave që nuk kanë të bëjnë qoftë edhe me mirëmbajtjen (pjesa e përditësimit të softuerit), apo te AKSHI-, që jep të gjitha garancitë që është një sistem funksional, si dhe përditësimi i sistemit nëpërmjet AKSHI-t.

QNOD-ja, ministria dhe inspektoratet e peshkimit në të gjitha portet do të kenë nga një link ku do të shikojnë situatën e anijeve të peshkimit në bregdet.

Sapo të kalojë ligji, AKSHI do të shpallë procedurat e tenderimit. Vjet ne e parashikuam ta kalonim nëpërmjet AZHBR-së, kurse sivjet e kemi të pamundur për ta kaluar

te AZHBR-ja dhe po e kalojmë me blerje me tenderim nëpërmjet AKSHI-t, i cili ka planifikuar edhe fondet për këtë qëllim.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Aparatet.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Presim të kalojë vetëm kjo çështje. Prandaj po ju kërkojmë që të nxitojmë.

Nuk përfundon vetëm me blerjen e aparateve, por do të ngrihet edhe sistemi i serverëve pranë AKSHI-t. Është një sistem komplet i ri që ka të gjithë pjesën e gjeoreferencimit. Është një sistem më kompleks që nuk përfundon vetëm me blerjen e disa aparateve.

Në lidhje me kuotat, Eli e tha, çështja e kuotave të eksportit të aquges është një problematikë shumë e madhe. Natyrisht, unë shpreh mendimin që çfarëdolloj ndërhyrjeje që bëhet në drejtim të rritjes së kuotave është e mirëpritur, qoftë në nivel të qeverisë, qoftë te prodhuesit.

Ne e ngritëm zyrtarisht. Është në një letër që ministri Peleshi në atë kohë ia ka dërguar zyrtarisht komisionerit Hanh dhe komisionerit Carmen Vela, ku kërkoi zyrtarisht rritjen e kuotave të eksportit. Në nënkomitetin “Bujqësia dhe Peshkimi”, që u mbajt në muajin dhjetor, një nga çështjet më kryesoret të diskutimit që ne kishim me Komisionin European ishte çështja e kuotave. Është një problematikë që kërkon negociim. Në rast se ata do të na rrisin kuotat, edhe ne duhet të lëshojmë, në fund të fundit, është pjesë komerciale. Pra, ne do të lëshojmë te qumështi, domatet apo diku tjetër në mënyrë që ata të na lejojnë për aqumen.

Niko Peleshi – Ka pyetje të tjera?

Nesër kemi diskutimin e projektligjit dhe me shpresë votimin në parim, nen për nen dhe në tërësi. Besoj se do të arrijmë të integrojmë disa vërejtje që na kanë ardhur me shkrim nga zonja Valbona Kolaneci. Ajo i është përgjigjur ftesës sonë për të dhënë kontribut për këtë projektligj. Është profesore e asociuar dhe ka një propozim serioz. Ka prekur disa nene dhe propozon ...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk e kemi Arianin këtu, i cili kishte këtë qasje për të cilën nuk biem dakord.

Të gjithë anëtarët e komisionit i kanë marrë propozimet dhe vërejtjet e zonjës Kolaneci me *e-mail*. Nëse dikush nuk i ka, Elona mund t’i printojë dhe t’ia japë. Ministria i ka marrë. Ju lutem që deri nesër të marrim një reflektim nga ana juaj. Pra, një koment mbi komentet. Nëse ka diçka që ju e gjykoni me vlerë, mund ta integrojmë në projektligj. Nëse

keni argumente që ndryshimet janë të panevojshme ose të pavenda, na i jepni me shkrim nesër që t'i kemi parasysh në diskutimet në komision. Me shpresë, nesër ta mbyllim procesin tonë, që të mos e shtyjme miratimin në seancë plenare në datën 7, siç është parashikuar në kalendar.

Kishe diçka Roland?

Roland Kristo - Unë i mora 10 minuta para se të vija këtu, por sidoqoftë mund t'jua japë tani të gjitha komentet në lidhje me këtë.

Niko Peleshi – I keni gati?

Roland Kristo – Jua them me gojë dhe më pas jua dërgoj me shkrim.

Ndryshimet në nenin 64\1 dhe 64\2 nuk merren parasysh, sepse janë përafrim 100% i rregullores së Bashkimit Europian.

E dyta, te pjesa e përkufizimit të peshkimit të vogël artizanal dhe peshkimit ..., është e vërtetë që të dyja janë të njëjtat terma, por ne i kemi përdorur të dyja format me qëllim që të mos cenohej ligji për lejet dhe licencat, sepse në ligjin për lejet dhe licencat ka emërtim ndryshe ...

Niko Peleshi – Të lutem, të gjitha këto që thua nuk mund t'i memorizojmë dot për sa kohë nuk i kemi studiuar vërejtjet. Kështu që, dërgojini me shkrim dhe i lëmë për mbledhjen e nesërme të komisionit.

Zonja Gjermani, keni gjë për të shtuar?

Eglantina Gjermani – Edhe unë dua t'ju falenderoj për angazhimin dhe kontributin tuaj! Në fakt, për të sqaruar opinionin publik për ndryshimet e ligjit të peshkimit, sepse ju thatë që ka qarkulluar në media, por opinionin publik nuk ka informacionin e duhur për këto ndryshime, ka keqinformim ose janë marrë pjesëza ose abuzim, unë e ngrita si shqetësim. Mbase ju keni përgjegjësinë që të sqaroni opinionin publik dhe ta informoni për këto ndryshime. Për më tepër që nuk prek peshkatarët ... Kjo edhe për impaktin pozitiv që do të ketë në punën tuaj për peshkimin, meqenëse ju ishit të angazhuar dhe mbështetës të tij.

Ju uroj suksese në punën tuaj dhe faleminderit për bashkëpunimin!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Roland Kristo – E gjithë sasia që importojmë dhe që peshkojmë.

Fatkeqësisht, një pjesë e kuotave tona zihet edhe nga açugja që importohet, përpunohet këtu dhe merr origjinën shqiptare. Kjo penalizon në një farë mënyre peshkun e kapur nga anijet tona. Eli e di, Gjergj Luca e di. Ne kemi dhënë mbështetje nëpërmjet kuadrit të AZHBR-së me 20 lekë për kilogramë për açugen e peshkuar me qëllim përpunimi. Vitin e kaluar është peshkuar açuge në sasi të konsiderueshme, e cila sot është në fazë maturimi dhe

do të fillojë eksporti. Açukja jonë del me origjinë shqiptare dhe nuk mund të marrë origjinë të Bashkimit European. Açugja e Bashkimit European merr origjinë shqiptare, por mund të qëndrojë edhe me origjinën e Bashkimit European

Niko Peleshi – Ka ndonjë nismë ligjore?

Roland Kristo – Është pjesë e negocimit që ne duhet të bëjmë. Ose duhet të bëhet një ndarje e kuotave midis subjekteve ose duhet gjetur një zgjidhje për këtë punë. Ne kemi qenë pjesë e diskutimeve dhe ju e dini shumë mirë çfarë do të thotë që një pjesë e açuges që vjen nga jashtë përpunohet këtu, merr origjinën shqiptare dhe pavarësisht se nuk është e peshkuar këtu ikën duke konsumuar kuotat që peshkojnë me të vërtetë anijet tona, të cilat nuk kanë mundësi t'ia ndryshojnë origjinën.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ka qenë një mijë ton. Në rast se do të kapej tetëdhjetëshja shtohet me 200 deri në 1600. Pastaj është mbyllur.

Niko Peleshi – Kemi ndonjë grafik për rritjen deri në vitin 2020?

Roland Kristo – E ka mbyllur me 1600. Vetë ata në nënkomitet thanë që është një proces i thjeshtë. Ne do të diskutojmë me të gjitha vendet anëtare dhe në rast se marrëveshja do të arrihet, do të miratohet nga të gjitha vendet anëtare të Bashkimit European. Nëse unë të jap, ti çfarë do më japësh. Siç është MSA-ja.

Niko Peleshi – Kuota për tonin është e hapur.

Roland Kristo – Ajo është tjetër gjë.

Niko Peleshi – Shumë faleminderit!

Shpresojmë që nesër ta mbyllim procesin.

Kam marrë një shqetësim, që e ka ngritur edhe zoti Bitri para disa ditëve, për përjashtimin nga TVSH-ja ...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Pra, në paketën e re fiskale kemi miratuar përjashtimin nga TVSH-ja të importeve të makinave dhe makinerive bujqësore. Ka qenë e përjashtuar për fermerët që importonin drejtpërdrejtë makineri bujqësore dhe ka pasur një handikap që kompanitë e rishitjes të makinerive bujqësore importonin me TVSH, sepse ligji përjashtonte vetëm fermerët, pra, vetëm importet e drejtpërdrejta. Kjo bëri që disa përfaqësues të kompanive të mëdha t'i mbyllin përfaqësitë këtu dhe të shkojnë në Maqedoni apo Kosovë dhe i bënin shitjet prej andej. E rregulluam këtë handikap me paketën e re fiskale, duke futur në këtë përjashtim edhe kompanitë që i blinin për rishitje.

Ndërkohë, shqetësimi është që ka ngecur në rrjetën e burokracisë. Pra, drejtoria e tatimeve pretendon që nuk ka marrë një listë, sepse duhet bashkëngjitur një listë me të gjithë emërtimet e makinave dhe makinerive bujqësore, doganat thonë që ne lexojmë vetëm makina dhe me makina nënkuptojmë traktorët dhe jo të tjerat. Pra, nuk po funksionon. Duhet që disa institucione të bashkëpunojnë për zbatimin e këtij ligji. Meqenëse komisioni ynë, si çdo komision parlamentar është përgjegjës edhe për ndjekjen e zbatueshmërisë të ligjeve, unë propozoj që ne të bëjmë një dëgjese ku të ftojme Ministrinë e Financave, Ministrinë e Bujqësisë, por edhe grupet e interesit.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nëse e gjykon Ministria e Financave, mund të thërrasim edhe tatimet apo doganat.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Më kujtohet që ne nga Ministria e Bujqësisë dërguam një shkresë në Ministrinë e Financave ku kërkuam që lista të ngelej ajo që ishte, sepse e kishim përjashtimin për fermerët. Nuk ishte nevoja të shpiknim një listë të re. Tani nuk e kuptoj se ku ka ngecur. Pse lista nuk u është komunikuar tatimeve dhe doganave? E gjykoni me vend që të bëjmë një dëgjese dhe të lëmë detyra nëse ka ngecur diku?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Besnik Baraj – Për efektivitet të kohës dhe punës do të ishte më mirë që dikush nga ne të ngarkohej me këtë çështje. Pra, të bënte 2-3 takime dhe të nxirrte një produkt. Në rast se ka nevojë për rakordime të disa institucioneve, organizojmë një dëgjese më të gjerë. Listë është, thjesht duhet të çohet diku.

Niko Peleshi – Edhe unë kështu mendoj. Kam frikë se anëtari që do të ngarkojmë do të na sjellë një problematikë dhe nuk është se zgjidhim gjë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kur mendoni ta vendosim datën e dëgjesës? Ndërkohë, të mos vonohemi, sepse u bë një muaj e gjysmë dhe ka ngecur tregtimi i makinerive bujqësore. E kam marrë nga disa importues këtë shqetësim.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Dakord, të mërkurën. Nuk ka nevojë për përgatitje.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk është e thënë të vijë ministrja. Le të vijë një përfaqësues, sekretarja e Përgjithshme ose dikush tjetër.

Nuk besoj se është për ministren.

Dakord, e lëmë të mërkurën.

Person – Pas akcizës që u vendos për granulën, këto ditë po haset problem edhe për plastmasin. Kjo është me shumë kosto për sektorin e bujqësisë. Me sa di unë, po merret edhe zëvendëskryeministri, por edhe kjo kërkon një ndërhyrje të shpejtë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Edhe unë e kam marrë këtë shqetësim.

Gjithsesi, ta kemi për axhendën e javës që vjen. Të informohemi për çfarë po bëhet, sepse mbase ka progres.

Besnik Baraj – Mbase këtu mund të bëjmë një dëgjese ku të artikulojmë shumë qartë me Ministrinë e Financave nëse mund të bëhet një hap pas në lidhje me këtë, sepse realisht rezulton shumë... Ata që prodhojnë sfungjerë dhe që kanë për bazë granulën janë shumë të shqetësuar, sepse është një taksë që i ka vështirësuar konkurrencën me fqinjët.

Niko Peleshi – Dakord, le ta mbajmë parasysh për axhendën e javës tjetër.

Ndërkohë, të mërkurën do të ftojme grupet relevante dhe përfaqësuesit e grupeve të interesit për çështjen e importit të makinerive bujqësore.

Faleminderit!

MBYLLET MBLEDHJA